

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore ***arsimi figurativ*** për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

## 1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore **arsimi figurativ** për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet /rezultatet e parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet rregullisht në bazë të planit mësimor të caktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, megjithatë duhet të ruhet fondi favor i orëve të parapara në programin e rregullt, përkatesisht për lëndë mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë mësimore në programin e shkurtuar.

Mësimdhënesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin mësimor të rregullt.

## 2. PASQYRA E TEMAVE DHE NJËSITË MËSIMORE

Tema: **Vizatimi** (6 orë)

- Njohja me temën, hasja e përbashkët ndërmjet kulturave, njeriut, punës dhe artit dhe varësia njërës nga tjetra, krijimi figurativ, gjuha dhe porosia/njohja me gjuhën figurative dhe porosia nga krijimi figurativ, njohja me nocionet detalisht dhe llojet;
- Gjuha figurative/Njohja me të gjitha stilet në art, karakteristikë e stileve, ndikimi i kulturave tjera në ndikimin e stilit të vizatimit/mjetet TIK;

- Elementet figurative dhe parimet/Njeh dhe analizon vizatimin si vepër artistike dhe dallon vizatimin linear nga ai tonal, ritmin dhe teksturën në vizatimin e fituar me materiale jo standarde shkallëzimi i tonit përmes teknikës dhe materialit për të vizatuar;
- Analiza e veprave figurative të nxënësit – vlerësimi estetik duke përdorur gjuhën figurative

Tema: **Pikturimi** (6 orë)

- Elementet figurative dhe parimet – materialet dhe teknikat/vrojtimi i dominantës në mjedis, zbatimi i kontrastit, studimi i pictures dhe vrojtimi i elementeve figurative dhe parimet të cilat e përbëjnë, nocioni për bashkim dhe krijimi i saj, radhitja dhe proporcioni i tyre;
- Elementet figurative dhe parimet – materialet dhe teknikat/shprehja dramatike dhe lirike në ngjyrë, veprimi i ngjyrës, ndërlidhja ndërmjet gjësendeve, të shfaqurit e portretit dhe shprehja dramatike, ndjenja për ngjyrën, teknikat e pikturimit për shprehjen lirike dhe dramatike, vrojtimi i teknikave të ndryshme dhe zbatimi i tyre në shprehjen figurative, shkallëzimi i tonit, të shprehurit e dominantës harmonike, krijimi i veprës së përbërë figurative;
- Përdorimi i mjeteve TIK/përmes korrelacionit të gjërave bën ndërlidhjen e detyrate, hulumtim të përfaqësuesve artistic të pictures nga bota dhe vepra, përsosja e teknikës prezantimi/përfaqësues të pictures ( ueb kuest)
- Analiza e veprave artistike të nxënësit – vlerësimi estetik duke përdorur gjuhën figurative.

Tema: **Grafika** (6 orë)

- Materialet dhe teknikat në grafikë, llojet e teknikave, përsosja e teknikës grafike, vulosja e veprave, mënyrat e ndryshme për gjurmim dhe llojet e ndryshme të vulosjes, vula me sitë;
- Materialet dhe teknikat në grafikë, përdorimi i mjeteve të TIK, ripërpunimi i fotografisë dhe kompozicioni i katalogut të shprehjeve artistike;
- Elementet artistike dhe parimet në grafikë – toni, shkallëzimi, forma, syprina dhe kompozicioni;
- Analiza e veprave figurative të nxënësit – vlerësimi estetik duke përdorur gjuhën figurative.

Tema: **Skulptura** (7 orë)

- Elementet figurative dhe parimet (forma, vëllimi, baraspesha, bashkimi, ngjyra) skica për skulpturë, video art, intervenimi, instalimi, formimi I zgjidhjeve të mundshme hulumtuese për intervenim, instalimi dhe video – art, njohja e elementeve figurative dhe parimet për krijimin e video – artit – mjetet TIK;
- Mjetet për modelimin e rëndësisë së teksturës dhe ngjyra në shprehjet figurative, krijimi i kompozitioneve dhe shprehja figurative, përkryerja e teknikave në skulpturën dhe përdorimin e materialeve jo standarde, formimi i objektit figurativ me komponimin e materialit të pikturens dhe skulpturës, instalimi i materialit jo të zakonshëm;
- Përfaqësues i skulpturës përmes hulumtimit të nxënësve që të bëjnë analizë të mësuarës me përfaqësues, përdorimi i mjeteve TIK;
- Analiza e veprave figurative të nxënësve – vlerësimi estetik duke përdorur gjuhën figurative

Tema: **Dizajni dhe komunikimi vizual** (7 orë)

- Elementet figurative dhe parimet në dizajn/krijimi I modës në skicë për veshjen nga mundësia e caktuar sipas inspirimit të veprave figurative nga një artist/(Van Gog), përdorimi i elementeve dhe parimeve të kombinuara figurative, dekorimi i funksionit të dizajnit, vineta, rozeta, rabeska, njohja me nacionin zbukurim, dekorim, rozeta, vineta, rabeska, krijimi i veprës figurative me kombinimin e elementeve figurative dhe parimeve – kompozicioni njohja me filigran, artar dhe endje, përdorimi i elementeve figurative dhe parimet në veprën personale, rëndësia dhe veprimtaria.
- Komunikimi visual llojet e përdorimit të mjeteve TIK dhe njohja me reklamën, spotin, bilbordin, ambalazhën dhe qëllimet e veta, kompozimet dhe krijimin e të njejtave, njohja e funksioneve të mediave. Llojet, njohja me dizajnin grafik dhe teknologjia industrial, varësitë njëra nga tjetra, ndikimi mbi njerëzit dhe komponimi I të njëjtave, njohja me nevojat shoqërore dhe përdoruese nga dizajni;

- Elementet figurative dhe parimet e nxënësit – përdorimi i mjetave TIK dhe vrojtimi i komunikimit visual me të gjithë llojet e artit POWER POINT;
- Analiza e veprave figurative të nxënësit – vlerësimi estetik duke përdorur gjuhën figurative.

### 3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Programi mësimor i shkurtuar në lëndën mësimore *arsimi figurativ* për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21, do të realizohet në 32 orë mësimore. Përbajtjet mësimore nga programi mbeten të njëja, por të radhitura në kuadër të 32 orëve mësimore. Është bërë përbledhja e përbajtjeve mësimore nga temat e njëja duke mbajtur llogari për ndërlidhjen logjike ndërmjet tyre. Rekomandohet që mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore ku integrong dy ose më tepër përbajtje mësimore, të jetë i kujdeshëm në aktivitetet dhe në kërkesat e dhëna. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi mësimore udhëhiqet nga rezultatet/qëllimet e pritura, nacionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

Përcjelljen e arritjeve të nxënësve mësimdhënësi individualisht e integrong në kuadër të orëve të parapara për realizim, duke përdorur metodat e ndryshme, teknikat dhe instrumentet. Informatat retroaktive në kohë dhe konstruktive ju mundëson nxënësve t'i identifikojnë hapat vijuese të nevojshme që të përparojnë në mësimnxënien e tyre.

Rekomandimet përfundin vjetor të orëve janë dhënë të orientuara së bashku me qëllimet konkrete dhe temat/përbajtjet. Mësimdhënësi nuk kufizohet në radhitjen e temave dhe përbajtjeve të nevojshme gjatë realizimit, por sipas kreativitetit personal dhe sipas arritjeve të nxënësve.

#### **4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin e kuadrit mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin mësimor të shkurtuar në lëndën mësimore *arsimi figurativ* për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21 e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

---

Milla Carovska